



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 12.5.2023

Nr: 507

Ora: 17:00

VENDIM

PËR

**SHQYRTIMIN E KËRKESAVE TË AMBASADAVE SUEDEZE, KROATE, MAQEDONISË SË VERIUT, BRITANISË SE MADHE, TË QENDRËS PËR BASHKËPUNIM DHE RRJETËZIM TË ORGANIZATAVE, PREZENCËS SË OSBE, PËR VËZHGIMIN E ZGJEDHJEVE PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

Sot në datën 12.5.2023, unë, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtova kërkesat me:

**KËRKUES**

Ambasada Suedeze, me adresë Rruga “ Pjetër Budi ”, Tiranë dhe me përfaqësuese zj. Elsa Håstad,

Ambasada Kroate, me adresë Rruga “Abdi Toptani”, Tiranë dhe me përfaqësues z. Zlatko Kramaric,

Ambasada e Republikës së Maqedonisë së Veriut, me adresë Rruga e Kavajës, nr. 116, Tiranë dhe me përfaqësues z. Dancho Markovski,

Qendra për Bashkëpunim dhe Rrjetëzim të Organizatave, (CCNO) me adresë Rruga “Adem Jashari” Prishtinë dhe me përfaqësuese zj. Mediana Bislimi,

Zyra e Prezencës së OSBE në Tiranë me përfaqësues Ambasadori Guido De Sanctis, Ambasada e Britanisë së Madhe me përfaqësues Ambasadorin Alastir King-Smith,

Data: 12.5.2023 Nr: 507  
Ora: 17:00



“Për shqyrtimin e kërkesave të Ambasadeve Suedeze, Kroate, Maqedonisë së Veriut, Britanisë së Madhe, të Qendrës për Bashkëpunim dhe Rrjetëzim të Organizatave, prezencës së OSBE, për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 Maj 2023”

**OBJEKTI:** Kërkohet akreditimi i përfaqësuesve të ambasadave për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 6, 7 e 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe vendimi nr. 19, datë 27.01.2023, i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja, dhe mediave”

### V Ë R E J:

Ambasada Suedeze i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën si dhe dokumentacionin përkatës për 7 (shtatë) vëzhgues afatshkurtër dhe 3 (tre) përkthyes, si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Kërkesa e paraqitur respekton afatin kohor të përcaktuar në nenin 6, pika 5, të Kodit Zgjedhor. Ambasada Suedeze është subjekt, i cili gëzon të drejtën të caktojë vëzhgues në zgjedhje, përcaktuar në nenin 6, pika 2, të Kodit Zgjedhor.

Ambasada Kroate i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën si dhe dokumentacionin përkatës për 3 (tre) vëzhgues afatshkurtër dhe 1 (një) përkthyes si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Kërkesa e paraqitur respekton afatin kohor të përcaktuar në nenin 6, pika 5, të Kodit Zgjedhor. Ambasada Kroate është subjekt, i cili gëzon të drejtën të caktojë vëzhgues në zgjedhje, përcaktuar në nenin 6, pika 2, të Kodit Zgjedhor.

Ambasada e Republikës së Maqedonisë së Veriut i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën si dhe dokumentacionin përkatës për 2 (dy) vëzhgues afatshkurtër, si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Kërkesa e paraqitur respekton afatin kohor të përcaktuar në nenin 6, pika 5, të Kodit Zgjedhor. Ambasada e Republikës së Maqedonisë së Veriut është subjekt, i cili gëzon të drejtën të caktojë vëzhgues në zgjedhje, përcaktuar në nenin 6, pika 2, të Kodit Zgjedhor.

Qendra për Bashkëpunim dhe Rrjetëzim të Organizatave i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën si dhe dokumentacionin përkatës për 12 (dymbëdhjetë) vëzhgues afatshkurtër, si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Kërkesa e paraqitur respekton afatin kohor të përcaktuar në nenin 6, pika 5, të Kodit Zgjedhor. Qendra për Bashkëpunim dhe Rrjetëzim të Organizatave është subjekt, i cili gëzon të drejtën të caktojë vëzhgues në zgjedhje, përcaktuar në nenin 6, pika 2, të Kodit Zgjedhor.

Zyra e Prezencës së OSBE në Tiranë i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën, si dhe dokumentacionin përkatës për 4 (katër) vëzhgues afatshkurtër, si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Kërkesa e paraqitur respekton afatin kohor të përcaktuar në nenin 6, pika 5, të Kodit Zgjedhor. OSBE është subjekt, i cili gëzon të drejtën të caktojë vëzhgues në zgjedhje, përcaktuar në nenin 6, pika 2, të Kodit Zgjedhor.

Ambasada e Britanisë së Madhe i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën si dhe dokumentacionin përkatës për 18 (tetëmbëdhjetë) vëzhgues afatshkurtër si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Kërkesa e paraqitur respekton afatin kohor të përcaktuar në nenin 6, pika 5, të Kodit Zgjedhor. Ambasada e Britanisë së Madhe është subjekt, i cili gëzon të drejtën të caktojë vëzhgues në zgjedhje, përcaktuar në nenin 6, pika 2, të Kodit Zgjedhor.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 6, 7 e 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe vendimit nr. 19, datë 27.01.2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja, dhe mediave”,

### **V E N D O S:**

1. Akreditimin e 7 (shtatë) vëzhguesve afatshkurtër dhe 3 (tre) përkthyesve të Ambasadës Suedeze, për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, sipas listës së përcaktuar në lidhjen 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Akreditimin e 3 (tre) vëzhguesve afatshkurtër dhe 1 (një) përkthyesi të Ambasadës Kroate për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, sipas listës së përcaktuar në lidhjen 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
3. Akreditimin e 2 (dy) vëzhguesve afatshkurtër të Ambasadës së Republikës së Maqedonisë së Veriut për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, sipas listës së përcaktuar në lidhjen 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
4. Akreditimin e 12 (dymbëdhjetë) vëzhguesve afatshkurtër të Qendrës për Bashkëpunim dhe Rrjetëzim të Organizatave për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, sipas listës së përcaktuar në lidhjen 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
5. Akreditimin e 4 (katër) vëzhguesve afatshkurtër të Zyrës së Prezencës së OSBE për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, sipas listës së përcaktuar në lidhjen 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
6. Akreditimin e 18 (tetëmbëdhjetë) vëzhguesve afatshkurtër të Ambasadës së Britanisë së Madhe për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, sipas listës së përcaktuar në lidhjen 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Data: 12.5.2023 Nr: 507  
Ora: 17:00



“Për shqyrtimin e kërkesave të Ambasadave Suedeze, Kroate, Maqedonisë së Veriut, Britanisë së Madhe, të Qendrës për Bashkëpunim dhe Rrjetëzim të Organizatave, prezencës së OSBE, për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 Maj 2023”

7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
8. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**

Data: 12.5.2023 Nr: 507  
Ora: 17:00



“Për shqyrtimin e kërkesave të Ambasadeve Suedeze, Kroate, Maqedonisë së Veriut, Britanisë së Madhe, të Qendrës për Bashkëpunim dhe Rrjetëzim të Organizatave, prezencës së OSBE, për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 Maj 2023”